

ALBAKONTROLL SH.P.K.  
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014  
(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Pozicionit Financiar  
Më 31 Dhjetor 2014

	Shënime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	4	16,378,603	16,905,569
Llogari të arkëtueshme	5	12,798,239	4,522,822
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	6	3,360,766	3,115,240
Inventari	7	16,666,153	11,027,278
Te tjera te arketueshme	8	1,345,130	2,336,110
<b>Total Aktive afatshkurtra</b>		<b>50,548,891</b>	<b>37,907,019</b>
<b>Aktivët afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	9	36,489,597	21,418,324
Aktive afatgjata jomateriale		-	55,430
Llogari te tjera te arketueshme (afatgjata)		-	
<b>Total aktive afatgjata</b>		<b>36,489,597</b>	<b>21,473,754</b>
<b>Total Aktive</b>		<b>87,038,488</b>	<b>59,380,773</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Hua afatshkurtra		-	
Llogari te pagueshme tregtare	10	15,495,919	7,980,325
Parapagimet te arketuara	11	410,217	
Detyrime tatimore	12	1,748,826	1,878,558
Llogari te pagueshme te tjera	13	15,706,386	17,901,298
<b>Total Detyrime afatshkurtra</b>		<b>33,361,348</b>	<b>27,760,181</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Hua afatgjata		-	
Grante,te ardhura te shtyra e te tjera detyrime		-	
Detyrime te tjera afatgjata	14	2,950,205	1,826,939
<b>Total Detyrime afatgjata</b>		<b>2,950,205</b>	<b>1,826,939</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>36,311,553</b>	<b>29,587,120</b>
<b>Kapitali themeltar</b>			
Kapitali themeltar		15,000,000	15,000,000
Rezerva te tjera		8,293,653	546,173
Rezerva ligjore		1,500,000	815,000
Fitime te mbartura		-	
Fitimi i ushtrimit	15	25,933,282	13,432,480
<b>Total kapitali</b>		<b>50,726,935</b>	<b>29,793,653</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>87,038,488</b>	<b>59,380,773</b>

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



ALBAKONTROLL SH.P.K.  
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Te Ardhurave dhe Shpenzimeve  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

Shenime	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014	Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013	
Te ardhura	16	116,584,418	81,156,220
Te ardhura te tjera	16	353,369	1,260,457
Shpenzime te aktivitetit kryesor	17	(43,419,629)	(22,690,871)
Shpenzime personeli	18	(18,187,867)	(15,755,547)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	19	(5,965,932)	(4,089,997)
Shpenzime te tjera	20	(19,867,022)	(25,454,952)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>29,497,337</b>	<b>14,425,310</b>
Te ardhurat/shpenzime financiare nga njesite e kontrolluara		-	-
Te ardhura/shpenzime financiare Neto	21	1,115,431	855,451
<b>Total shpenzime financiare</b>		<b>1,115,431</b>	<b>855,451</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>30,612,768</b>	<b>15,280,761</b>
Shpenzime tatim fitimi i shtyre		-	-
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(4,679,486)	(1,848,281)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>25,933,282</b>	<b>13,432,480</b>

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



**ALBAKONTROLL SH.P.K.**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014**  
*(Vlerat janë në Lekë)*



Pasqyra e Levizjeve të Kapitalit  
 Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Kapitali themeltar	Rezerva të tjera	Rezerva ligjore	Fitime të mbartura /humbje të akumuluar	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
01 Janar 2013	15,000,000	546,173	815,000		4,548,424	20,909,597
Fitimi i vitit					13,432,480	13,432,480
Pakesim i rezervave të tjera						-
Dividendë të paguar					(4,548,424)	(4,548,424)
<b>31 Dhjetor 2013</b>	<b>15,000,000</b>	<b>546,173</b>	<b>815,000</b>	<b>-</b>	<b>13,432,480</b>	<b>29,793,653</b>
Transferim në fitime të mbartura			685,000		(8,432,480)	-
Fitimi i vitit		7,747,480			25,933,282	25,933,282
Pakesim i rezervave ligjore						-
Dividendë të paguar					(5,000,000)	(5,000,000)
<b>31 Dhjetor 2014</b>	<b>15,000,000</b>	<b>8,293,653</b>	<b>1,500,000</b>	<b>-</b>	<b>25,933,282</b>	<b>50,726,935</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 u aprovuan nga Administratori i Albakontroll sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë më 27 Mars 2015 nga:

Alban Shehri  
 Administrator


ALBAKONTROLL SH.P.K.  
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014  
(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Fluksit të Parasë  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

	Shënime	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>			
Fitimi para tatimit		30,612,768	15,280,761
Axhustime për zërat jo-monetare:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi		5,965,932	4,089,997
Te ardhura nga shitja e Aktiveve Afatgjata Materiale			
Nxjerrja jashtë përdorimit e Mjeteve fikseve, neto nga fitimi kapital			
<b>Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues</b>		<b>36,578,700</b>	<b>19,370,758</b>
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues</i>			
Ndryshimi në inventar		(5,638,875)	9,308,592
Ndryshimi në llogari të arketueshme dhe të tjera		(7,284,437)	869,047
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera		3,383,929	(10,801,627)
Ndryshimi në parapagime e shpenzime të shtyra		(245,526)	(733,240)
Ndryshimi në te ardhura të shtyra			
<b>Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>		<b>26,793,791</b>	<b>18,013,530</b>
Interesa të paguara			
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit		(4,042,931)	(1,848,281)
		<b>(4,042,931)</b>	<b>(1,848,281)</b>
<b>Aktivitetet investuese</b>			
Blerje të aktiveve afatgjata material		(20,981,775)	(9,073,207)
Shitje të aktiveve afatgjata material			
Blerje e shoqërisë së kontrolluar minus parate e arketuara			
Interesa të marra			
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues</b>		<b>(20,981,775)</b>	<b>(9,073,207)</b>
<b>Aktivitetet financuese</b>			
(Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata			
Shtesa/pakesime në qera financiare		2,703,949	(775,895)
Dividendë paguar		(5,000,000)	(4,548,424)
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues</b>		<b>(2,296,051)</b>	<b>(5,324,319)</b>
<b>Ndryshimi neto i mjeteve monetare</b>		<b>(526,966)</b>	<b>1,767,723</b>
Mjetet monetare në fillim të periudhës		16,905,569	15,137,846
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>		<b>16,378,603</b>	<b>16,905,569</b>

Pasqyra e fluksit të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



## 1. TË PËRGJITHSHME

Shoqëria "Albakontroll" shpk është regjistruar në Rregjistrin e Shoqërive me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë datë 24.01.2005. Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT, K51325001V.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është operimi si agjensi doganore, spedicionere dhe transporti, agjensi turistike, shërbim postar ekspres, kontroll sasior dhe çilesor i mallrave, etj. Veprimtari në fushën e dhenies me qera të mjeteve të transportit. Veprimtari në fushën e shitjes me shumicë e pakicë të produkteve të telefonisë dhe aparaturave telefonike.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 15,000,000 Leke i cili zotërohet nga ortakët i vetëm i shoqërisë Alban Shehri.

Administrator i shoqërisë është Alban Shehri.

Selia kryesore e shoqërisë ndodhet në Njësine Bashkiake nr 7, Rruga e Kavajes, Pall. "Constal", Kati 5, Shkalla 3, Ap 26, Tiranë.

## 2. BAZAT E PËRGATITJES

### 2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

### 2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### 2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### 2.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.



**3. POLITIKAT KONTABËL**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

**3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 është detajuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
<b>Kurset e këmbimit</b>		
Euro/Lek	140.14	140.20
Usd/Lek	115.23	101.86

**3.2 Instrumenta financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

*Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

*Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.



### 3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

#### 3.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve.

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

##### *Kapitali themeltar*

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.



**3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)****3.4 Aktive afatgjata materiale***i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

*iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin aktual është si më poshtë:

Aktive	Përqindja
Makineri dhe Pasije	20%
Pajisje informatike	25%
Mobilje zyre	20%
Mjete Transporti	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

**3.5 Provigjonet**

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

**3.6 Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.





(Vlerat janë në Lekë)

**3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)****3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

**3.8 Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

**4. MJETE MONETARE**

Teprica e likuiditeteve për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2014 dhe atë që mbyllet me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>Më 31 Dhjetor 2013</u>
Mjete monetare në banke	15,811,469	16,827,064
Llogari rrjedhese	4,188,198	6,559,460
Depozita me afat	11,623,271	10,267,604
Mjete monetare në arke	567,134	78,505
<b>Totali</b>	<b><u>16,378,603</u></b>	<b><u>16,905,569</u></b>

**5. LLOGARI TË ARKËTUESHME**

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë detyrime të pa arkëtuara nga klientët në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare.

Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Kliente	12,798,239	4,522,822
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	-	-
<b>Totali</b>	<b><u>12,798,239</u></b>	<b><u>4,522,822</u></b>



## ALBAKONTROLL SH.P.K

## Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

## 6. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TE SHTYRA

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

Ne kete ze jane paraqitur shpenzime te shtyra te cilat i perkasin periudhave te ardheshme dhe sigurimet e parapaguara.

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Sigurime te parapaguara	1,915,813	-
Shpenzime te shtyra	1,444,953	3,115,240
<b>Totali</b>	<b><u>3,360,766</u></b>	<b><u>3,115,240</u></b>

## 7. INVENTARI

Inventari më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Lende e pare	-	-
Mallra per rishitje	16,666,153	11,027,278
Parapagime per furnizime	-	-
<b>Totali</b>	<b><u>16,666,153</u></b>	<b><u>11,027,278</u></b>

## 8. LLOGARI TE TJERA TE ARKETUESHME

Ne kete ze janë perfshire te drejtat ne lidhje me marrëdhëniet qe ka shoqëria me Doganen, paradhëniet per punonjës dhe llogarite e përkohshme, balanca e te cilave me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqitet si me poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Dogana	123,100	-
Debitore punonjes	670,000	2,336,110
Llogari e perkohshme (tvsh leasing)	552,030	-
<b>Totali</b>	<b><u>1,345,130</u></b>	<b><u>2,336,110</u></b>

## 9. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

	Ndërtesa	Komputera	Paisje zyre	Mjete transporti	Parapagime per AAM	Totali
<b>Kosto</b>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	894,796	1,602,055	739,797	16,185,152	-	19,421,800
Shtesa	(894,796)	217,278	403,672	13,143,634	-	13,764,584
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	(4,636,486)	-	(5,531,282)
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2013</b>	-	<b>1,819,333</b>	<b>1,143,469</b>	<b>24,692,300</b>	-	<b>27,655,102</b>
Shtesa	-	831,113	84,100	18,980,648	3,720,305	23,616,166
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(53,687)	-	(2,546,966)	-	(2,600,653)
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2014</b>	-	<b>2,596,759</b>	<b>1,227,569</b>	<b>41,125,982</b>	<b>3,720,305</b>	<b>48,670,615</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	30,845	292,980	122,531	2,540,325	-	2,986,681
Amortizimi i vitit	-	329,539	183,588	3,591,870	-	4,104,997
Nxjerrje jashtë përdorimit	(30,845)	-	-	(824,055)	-	(854,900)
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2013</b>	-	<b>622,519</b>	<b>306,119</b>	<b>5,308,140</b>	-	<b>6,236,778</b>
Amortizimi i vitit	-	365,298	172,714	5,427,920	-	5,965,932
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	(21,692)	-	-	-	(21,692)
<b>Gjëndja më 31 Dhjetor 2014</b>	-	<b>966,125</b>	<b>478,833</b>	<b>10,736,060</b>	-	<b>12,181,018</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>						
Gjendja më 31 Dhjetor 2012	863,951	1,309,075	617,266	13,644,827	-	16,435,119
Gjendja më 31 Dhjetor 2013	-	1,196,814	837,350	19,384,160	-	21,418,324
Gjendja më 31 Dhjetor 2014	-	1,630,634	748,736	30,389,922	3,720,305	36,489,597



**10. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE**

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikuiduara ndaj furnitorëve. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Te pagueshme ndaj furnitorëve	15,495,919	7,980,325
<b>Totali</b>	<b><u>15,495,919</u></b>	<b><u>7,980,325</u></b>

**11. PARAPAGIMET E ARKETUARA**

Ne kete ze jane paraqitur parapagimet e arketuara nga klientet, balanca e te cileve paraqitet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Parapagimet e arketuara	410,217	
<b>Totali</b>	<b><u>410,217</u></b>	<b><u>-</u></b>

**12. DETYRIME TATIMORE**

Balanca e detyrimeve tatimore me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqitet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Detyrime per sigurime shoqerore & shendetesore	295,833	258,271
Detyrime per tatimin mbi te ardhurat personale	52,742	42,832
Tatim ne burim	91,769	
TVSH per tu paguar	401,858	1,307,386
Tatim fitimi	906,624	270,069
<b>Totali</b>	<b><u>1,748,826</u></b>	<b><u>1,878,558</u></b>

**13. LLOGARI TE PAGUESHME TE TJERA**

Detyrimet te tjera më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>	<u>31 Dhjetor 2013</u>
Detyrime afatshkurtra per Qera Finaniare	1,580,683	
Paga per t'u paguar	317,815	1,536,794
Dividend per tu paguar	4,000,000	4,093,582
Detyrime te tjera ndaj ortakut	9,263,484	11,776,484
Debitore dhe kreditore te tjere	544,404	494,438
<b>Totali</b>	<b><u>15,706,386</u></b>	<b><u>17,901,298</u></b>



## 14. DETYRIME AFATGJATA

Ne kete ze paraqiten detyrimet afatgjata per qerate financiare, balanca e se cilave me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqitet si me poshte:

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Detyrime afatgjata per Qera Finaniare	2,950,205	1,826,939
<b>Totali</b>	<b>2,950,205</b>	<b>1,826,939</b>

## 15. KAPITALI THEMELTAR

## Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 15,000,000 Lekë.

## Rezerva ligjore

Rezerva ligjore më 31 Dhjetor 2014 paraqitet në vlerën 1,500,000 Lekë.

## Rezerva të tjera

Rezerva të tjera më 31 Dhjetor 2014 paraqitet në vlerën 8,293,653 Lekë.

## Fitimi i ushtrimit

Shuma prej 25,933,282 Lekë perfaqëson fitimin e vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2014.

## 16. TË ARDHURAT

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Te ardhura nga shitja e mallrave	22,591,681	24,021,276
Te ardhura nga komisionet	38,880,724	39,114,399
Te ardhura nga makina me qera	17,387,409	958,762
Te ardhura si agjensi doganore	16,239,013	10,698,371
Te ardhura nga transporti	16,472,047	4,907,854
Të ardhura si agjensi turistike	5,013,544	1,556,401
Te ardhura nga shitje e AAM-ve	229,997	-
Te ardhura te tjera	123,372	1,159,614
	<b>116,937,787</b>	<b>82,416,677</b>



(Vlerat janë në Lekë)

**16. TË ARDHURAT**

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 janë në vlerën prej 116,937,787 Leke. Të ardhura të deklaruara në Drejtorine Tatimore gjatë 2014 janë në vlerën prej 497,194,499 Leke.

Ndryshimi prej 380,610,081 Leke analizohet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2014</u>
<b>Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne</b>	
Qarkullim i tatueshem	497,194,499
Zbriten parapagimet e mara	(410,217)
Zbriten faturimet e Vodafone per anulimin e komisioneve te marra	(26,325)
Shtohet e ardhura neto nga shitja e AAM	229,997
Zbriten cmimi i shitjes se AAM	(2,808,959)
Zbriten te ardhurat nga veprimtaria si distributor	(377,364,580)
Te ardhura te tjera sistemime llogarie	123,372
<b>Shuma e qarkullimit e korrektuar</b>	<b>116,937,787</b>
Sipas Kontabilitetit	116,937,787
Diferenca	-

**17. MATERIALE TE PARA DHE TE KONSUMUESHME**

Kosto e mallrave te shitura, komisioneve dhe te tjera qe lidhen me aktivitetin kryesor per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 dhe ate te mbyllur me 31 Dhjetor 2013 paraqitet si me poshte:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime kryesore te aktivitetit (mallra, komision....)	43,419,629	22,690,871
	<b>43,419,629</b>	<b>22,690,871</b>

**18. SHPENZIMET E PERSONELIT**

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013</u>
Shpenzime per paga	15,973,325	14,091,185
Shpenzime per sigurime shoq e shend	2,214,542	1,664,362
	<b>18,187,867</b>	<b>15,755,547</b>



(Vlerat janë në Lekë)

## 19. SHPENZIME ZHVLERËSIMI DHE AMORTIZIMI

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Shpenzime amortizimi	5,965,932	4,089,997
	<u>5,965,932</u>	<u>4,089,997</u>

## 20. SHPENZIME TË TJERA

Këto shpenzime janë analizuar në tabelën e mëposhtme:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Blerje Energji, avull, uje karburant	1,017,795	1,676,608
Shpenzime qeraje	8,174,164	7,982,208
Mirëmbajtje dhe riparime	2,023,525	1,312,041
Sigurime	2,218,162	3,431,302
Sherbime te ndryshme	527,721	2,112,050
Udhetime e dieta	249,909	112,854
Blerje te ndryshme, kancelari etj	1,228,085	1,244,839
Sherbime nga te trete	736,149	
Karburant	690,785	
Publicitet, reklama	245,333	243,292
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	895,814	1,046,383
Shpenzime transpoti	-	151,000
Komisione bankare	151,649	56,636
Taksa te ndryshme	240,570	427,495
Gjoha te ndryshme	374,042	148,789
Shpenzime te ndryshme, dhurata	-	3,055,314
Shpenzime trainime, panaire etj	550,199	
Shpenzime pritje e perfaqesimi	408,626	278,996
Vlera kontabel neto e AAM	-	1,159,845
Te tjera	134,494	1,015,300
<b>Totali</b>	<u><b>19,867,022</b></u>	<u><b>25,454,952</b></u>

*Dalja jashte perdorimit dhe shitja e aktiveve afatgjata materiale*

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Te ardhura nga shitja e AAM	2,808,959	5,756,127
Shpenzime nga shitja e AAM	(2,578,962)	(6,915,972)
<b>Rezultati Neto nga shitja e AAM</b>	<u><b>229,997</b></u>	<u><b>(1,159,845)</b></u>



## ALBAKONTROLL SH.P.K

## Shënime shoqëruese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014

(Vlerat janë në Lekë)

## 21. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA FINANCIARE

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare janë analizuar si me poshte:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2014	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2013
Shpenzime per interesa leasingu	(263,438)	(265,538)
Te ardhura nga interesat	65,879	951,978
Humbje nga kembimet valutore	(8,127)	169,011
Te ardhura nga kembimet valutore	1,321,117	
	<u>1,115,431</u>	<u>855,451</u>

## 22. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2013: 10%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	Më 31 Dhjetor 2014	Më 31 Dhjetor 2013
<i>Fitimi para tatimit</i>	30,612,768	15,280,761
Shpenzime te panjohura te tjera (si me poshte):	583,803	3,202,052
- Penalitet, gjoba e demshperblime	374,042	
- Shpenzime te tjera	209,761	3,202,052
Shpenzime dega Kosove		
<i>Fitimi fiskal para tatimit</i>	<u>31,196,571</u>	<u>18,482,813</u>
Shpenzime tatim fitimi	4,679,486	1,848,281
<i>Fitimi pas tatimit</i>	25,933,282	13,432,480

## 23. PALET E LIDHURA

Keto perfaqesojne transaksionet me palet e lidhura, per shembull aksioneret e shoqerise, dhe njesite e kontrolluara, te kontrolluara bashkarisht ose kane nje ndikim te konsiderueshem nga palet e tilla.

Balancat me palet e lidhura te perfshire ne pasqyren e pozicionit financiar detajohet si me poshte:

	Më 31 Dhjetor 2014	Më 31 Dhjetor 2013
<b>Bilanci kontabël</b>		
<i>Të pagueshme ndaj palëve e lidhura</i>		
Ortaku- Dividend per tu paguar	4,000,000	4,093,582
Detyime te tjera ndaj ortakut	9,263,484	11,776,484
	<u>13,263,484</u>	<u>15,870,066</u>





#### 24. ANGAZHIME DHE PASIGURI

##### *Çeshtje gjyqesore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2014 Shoqëria nuk ka asnjë çeshtje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

##### *Detyrimet tatimore*

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

#### 25. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

